- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

- 1. Matrapik i madh me goditje dhe rrotullim.** Matrapiku duhet të ofrojë të dyja proceset në varësi të kërkesës së përdoruesit, procesin e operimit me goditje dhe procesin e operimit me rrotullim për hapje vrimash rrethore me frezë. Matrapiku duhet të jetë efikas, i shpejtë dhe kompakt në përdorim duke mundësuar kryerjen e punës me precision të lartë dhe të sigurtë. Gjithashtu kërkohet që matrapiku të jetë me peshë të lehtë që të përdoret për punime civile edhe në lartësi. Minimalisht të shoqërohet me një set puntosh dhe një set frezash me diapazon brenda të cilit realizohet lehtësisht punimi me këtë matrapik. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 1600W$
 - ✓ Forca goditëse: $\geq 8 J$
 - ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: $\geq 550 rpm$
 - ✓ Tensioni: 220-240V ~50/60Hz
 - ✓ Max shpimit: 13-38 mm
 - ✓ Sistem: Antivibrim
 - ✓ Lloji i madrinos: SDS-max ose SDS-plus
- 2. Matrapik i madh për thyerje.** Matrapiku duhet të mundësojë procesin e thyerjes dhe prishjen e strukturave të forta, inerte të cilat mund të jenë në ndërtime fasade objektesh apo infrastrukurore. Matrapiku duhet të jetë efikas, i shpejtë dhe kompakt në përdorim duke mundësuar kryerjen e punës me precision të lartë dhe të sigurtë. Minimalisht të shoqërohet me një set daltash tip kryq dhe me një set daltash tip pllakë me diapazon brenda të cilit realizohet lehtësisht punimi me këtë matrapik. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 1700\text{W}$
- ✓ Forca goditëse : $\geq 40\text{ J}$
- ✓ Tensioni: 220-240V ~50/60Hz
- ✓ Sistem: Antivibrim
- ✓ Lloji madrinos: SDS-max ose SDS-plus

- 3. Matrapik i vogël.** Matrapiku duhet të jetë i përshtatshëm për shpime dhe prishje të sipërfaqeve inerte izoluese si suva, beton, pllaka. Paisja duhet të jetë me peshë të lehtë që të mundësojë operim sa më të lehtë dhe të sigurtë për përdoruesin. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 800\text{ W}$
- ✓ Tensioni: 220-240 V
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: $\geq 1100\text{ rpm}$
- ✓ Numri i goditjeve: 0-4000 rrot/min
- ✓ Fuqia e goditëse: $\geq 2.5\text{ J}$
- ✓ Shpimi ne beton: 13-30 mm
- ✓ Lloji i mandrinos: SDS-max ose SDS-plus

- 4. Trapan me rrotullim dhe goditje.** Trapani duhet të jetë profesional dhe i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe betoni, metal dhe dru duke mundësuar vapjen e vrimave për çiftëzim mekanik të suportit. Të jetë minimalisht me 2 (dy) regjistra shpejtësi të rregullueshme, maksimumi i shpimit metal $\geq 16\text{ mm}$, beton $\geq 24\text{ mm}$ dru -40 mm. Të shoqërohet me dy sete puntosh origjinale për metal dhe për beton sipas diapazonit të pajisjes. Trapani duhet të jetë kompakt si konstrukcion dhe rezistent ndaj energjisë termike të çliruar si pasojë e punës së elementëve mekanikë në të. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 1100\text{W}$
- ✓ Tensioni: 230-240V
- ✓ Frekuenca: 50/60Hz
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit : $\geq 2800\text{ rpm}$
- ✓ Madrino: Me çelës
- ✓ Trupi i trapanit: Alumin + Kompozite

- 5. Trapan me goditje me bateri.** Trapani duhet të mundësojë të dyja funksionet gjatë operimit, funksionin goditës dhe shpues. Trapani duhet të jetë i kompakt dhe i lëvizshëm dhe të ketë jo më pak se 2 (dy) bateri të karikueshme dhe të paktën një karikues. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Tensioni: $\geq 18\text{V}$
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: $\geq 400\text{-}1400\text{ rrot/min}$
- ✓ Momenti rrotullimit: $\geq 40\text{ Nm}$
- ✓ Lloji baterise: Li-ion $\geq 2.0\text{ Ah}$
- ✓ Nr. baterive: 2
- ✓ Karikimi: 100-240V~50/60Hz

-
- 6. Trapan me goditje me bateri për punime skelerie.** Trapani duhet të mundësojë të dyja funksionet gjatë operimit, funksionin goditës dhe shpues. Trapani duhet të jetë i kompakt dhe i lëvizshëm dhe të ketë jo më pak se 2 (dy) bateri të karikueshme dhe të paktën një karikues. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Tensioni: $\geq 18V$
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: 800-1400 rpm
- ✓ Forca goditëse: deri 4000 bpm
- ✓ Fuqia e shpimit: deri 24mm në beton
- ✓ Lloji baterise: Li-ion $\geq 5.0Ah$
- ✓ Nr baterive: 2
- ✓ Karikimi: 100-240V~50/60Hz
- ✓ Lloji madrinos: SDS-max ose SDS-plus

- 7. Aparat fresibël i vogël.** Pajisja duhet të bëjë të mundur prerjen profileve hekur dhe profileve të tjera metalike me seksion të ngushtë. Pajisja duhet të jetë e përshtatshme për axhustime. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 850W$
- ✓ Tensioni: 220-240V
- ✓ Frekuenca: 50/60Hz
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: 6000-13000 rpm
- ✓ Disku: 125mm
- ✓ Aksi i kapjes të diskut: M14
- ✓ Trupi: Alumin + Kompozite

- 8. Aparat fresibël i madh.** Pajisja duhet të bejë të mundur prerjen e profileve metalike të spesorëve të ndryshëm. Pajisja duhet të jetë e përshtatshme dhe për axhustime. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 2400W$
- ✓ Tensioni: 220-240V
- ✓ Frekuenca: 50/60Hz
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: 6000-12000 rpm
- ✓ Disku: 230mm
- ✓ Aksi i kapjes të diskut: M14
- ✓ Trupi: Alumin + Kompozite

- 9. Vidiator me bateri me goditje.** Vidiatori me bateri duhet të mundësoj shpime në sipërfaqe të buta druri, metali. Gjithashtu vidiatori duhet të bëjë të mundur vrimëzimin për fiksime të nevojshme. Është e rëndësishme që vidiatori të jetë me dy opsione, vrimëzim në krah orar and anti-orar. Minimalisht të shoqërohet me një set puntosh me diapazon brenda të cilit realizohet lehtësisht punimi me këtë tip vidiatori dhe të ketë jo më pak se 2 (dy) bateri të karikueshme dhe të paktën një karikues. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

-
- ✓ Tension: $\geq 18V$
 - ✓ Bateria: $\geq 1.5Ah$
 - ✓ Momenti i rrotullimit: $\geq 30 Nm$
 - ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: $\geq 1300 rpm$
 - ✓ Kontrolli i shpejtësisë: $\geq 15+1$
 - ✓ Bateria: Li-ion x 2 copë
 - ✓ Karikimi: 100-240V~50/60Hz

10. Aparat ngjitës për tuba plastik. Aparat për ngjitje tubi plastik të mundësoje ngjitjen e tubave dhe rakorderive të materialit PPR, me një fuqi mbi 800W, dhe një temperaturë pune 300°C. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: $\geq 800W$
- ✓ Tensioni: 220V-240V
- ✓ Frekuenca: 50/60 Hz
- ✓ Diametri: 22-63mm
- ✓ Rryma termike: 5mA
- ✓ Reostat: Po
- ✓ Temperatura maksimale (*C) : 300

11. Aparat matje intensitetit të rymave me nofull profesional. Multimetri duhet të mundësojë matjen me precizion të lartë të voltazhit, rrymën dhe rezistencën në një seksion përcjellësi. Multimetri duhet të jenë i sigurt në përdorim dhe i përbërë me materiale të klasifikuara si gjysëm-përcjellës dhe jo përcjellës. Pjesa e kontaktit në darat e multimetrit duhet të jetë i përbërë prej materiali përcjellës të mirë të rrymës elektrike në mënyrë që të kryejë matjen e saktë. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Tipi: Multimetër
- ✓ Modeli: Me bateri
- ✓ Ekрани: Dixhital
- ✓ Voltazhi AC: 60mV/600mV
- ✓ Frekuenca: 0~10KHz $\pm (1.5\%+5)$

12. Pompë mjegulluese e ftohtë, elektrike. Pompë spërkatëse mjegulluese për përdorim specifikisht për zgjidhjet sanitizuese, antibakteriale dhe antivirale, për të luftuar viruse, myk, baktere, kërpudha etj, por që mund të përdoret gjithashtu për detyra të tjera si kontrolli i insekteve dhe dëmtuesve në zona të mbyllura dhe të jashtme. Pompa mjegulluese duhet të përdoret si spërkatës statik ose i mbajtur me dorë duke patur të instaluar mekanizëm të rregullimit të këndit të sprucimit në drejtimin vertikal sipas nevojave të përdoruesit. Pompa mjegulluese duhet të jetë e pajisur me mekanizëm të rregullimit manual të llojit të sprucimit me një diapazon nga 5 ± 2 micron deri 50 ± 2 micron sipas natyrës së përdorimit. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- Kategoria – Mjegullues i ftohtë elektrik

- Tensioni: 220/240 volt AC
- Gjatësia e kabullit elektrik: 10m-15m
- Shpejtësia e xhirove të motorrit: 30 000 rpm \pm 2000rpm
- Fuqia e motorrit: 1200W-1500W
- Tipi i sprucimit: mjegull (fog type) ULV
- Këndi i injeksionit: $\geq 80^\circ$
- Madhësia e grimcave të sprucimit: $5 \mu\text{m} \pm 1 \mu\text{m}$ deri $50 \mu\text{m} \pm 2 \mu\text{m}$ (micron)
- Pesha bosh: 4 kg – 5 kg
- Dimensionet: Gjatësia \rightarrow 60cm \pm 10cm \times Gjerësia \rightarrow 20cm \pm 5cm \times Lartësia \rightarrow 30cm \pm 5cm
- Materiali: plastik ose ekuivalent
- Kapaciteti i depozitës së solucionit: 5- 7 litra
- Norma e prodhimit: ≥ 50 litra/orë
- Largësia maksimale e hedhjes së sprucimit: jo më pak se 10m
- Presioni: ≥ 30 kpa
- Garancia: ≥ 12 muaj

Standartet që duhet të plotësojë:

Standartet Shqiptare SSH EN 55014-1:2017/A11:2020 ose ekuivalentin e tij dhe SSH EN 61000-4-2:2019 ose ekuivalentin e tij.

13. Sharrë rrethore. Pajisja duhet të jetë e përshtatshme për prerje dhe dizenjim të materialit të drurit. Sharra duhet të jetë stabile dhe e sigurtë në përdorim. Gjithashtu sharra duhet të ofrojë mundësinë për të operuar në të gjitha këndet. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia: ≥ 2200 W
- ✓ Disku: 230 mm/60 dhëmbë
- ✓ Kapaciteti i prerjes: $45^\circ - 65$ mm / $90^\circ - 80$ mm
- ✓ Numri i rrotullimeve bosh: deri 3800 rpm
- ✓ Tensioni: 220-240V
- ✓ Frekuenca: $\sim 50/60$ Hz

14. Pompë për lyerje muri. Shërben për lyrjen e sipërfaqeve të ndryshme me bojë plastike pa presion ajri. Përbëhet nga motorri elektrik dhe të gjithë aksesorët e nevojshëm për lyerje. Produkti duhet të ofrohet me një garanci jo më pak se 12 muaj.

Të dhënat teknike:

- ✓ Fuqia e motorrit: ≥ 1200 W
- ✓ Tensioni: 220/240 V
- ✓ Frekuenca: 50/60Hz
- ✓ Shpejtësia e xhirove të motorrit: deri 5000 rpm
- ✓ Sasia e spërkatjes: ≥ 2 litra/min
- ✓ Pesha e produktit: jo më shumë se 20kg

15. Skelë kullë e lëvizshme. Skela të jetë e lëvizshme me rrota, e përbërë nga elementë prej çeliku të galvanizuar. Kjo skelë nuk duhet të ketë nevojë për mbështetje në mur por duhet të jetë e projektur për montim dhe qëndrim të pavarur. Të ketë jo më pak se 2 (dy) platforma pune të lëvizshme prej çeliku të galvanizuar ose alumini. Të jetë projektuar për të qenë një produkt i lehtë për t'u montuar dhe të jetë çertifikuar sipas standardeve shqiptare SSH EN 1004 ose ekuivalente.

Të dhënat teknike:

- ✓ Materiali: Çelik i zinkuar
- ✓ Elementët: Ø 40-50mm
- ✓ Lartësia maksimale: ≥ 800 cm
- ✓ Përmasa e bazës mbajtëse: 100/120 cm x 180/200 cm

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat do të lëvrohen në lloj dhe sasi periodikisht, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit. Mallrat objekt prokurimi duhet të jenë të reja dhe duhet të jenë ruajtur në kushte magazinimi të cilat nuk kanë sjellë ndryshimin e cilësisë si korrozioni, dëmtimet nga goditjet etj. Kontraktori është i detyruar që me automjetet e veta dhe me punonjësit e tij të realizojë dërgimin e mallit në destinacionin e parashikuar në DST dhe kontratë brenda kushteve teknike dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në kohë dhe sasi sipas afateve të parashikuara në kontratë.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i Mallrave	Njësia	Sasia
1	Matrapik i madh me goditje dhe rrotullim	copë	2
2	Matrapik i madh për thyerje	copë	2
3	Matrapik i vogël me goditje dhe rrotullim	copë	3
4	Trapan, me rrotullim dhe goditje	copë	8
5	Trapan me goditje me bateri	copë	5
6	Trapan me goditje me bateri për punime skelerie	copë	2
7	Aparat fresibël i vogël	copë	5
8	Aparat fresibël i madh	copë	5
9	Vidiator me bateri me goditje	copë	8
10	Aparat ngjitës për tuba plastik	copë	4
11	Matës i intensitetit të rrymave me nofull, profesional	copë	7
12	Pompë mjegulluese e ftohtë (ULV), elektrike	copë	2
13	Sharrë rrethore	copë	3
14	Pompë për lyerje muri	copë	1
15	Skelë kullë e lëvizshme	copë	1

Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i Mallrave	Njësia	Sasia gjithsej	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Matrapik i madh me goditje dhe rrotullim	copë	2	DPOP	30 ditë
2	Matrapik i madh për thyerje	copë	2	DPOP	30 ditë
3	Matrapik i vogël me goditje dhe rrotullim	copë	3	DPOP	30 ditë
4	Trapan, me rrotullim dhe goditje	copë	8	DPOP	30 ditë
5	Trapan me goditje me bateri	copë	5	DPOP	30 ditë
6	Trapan me goditje me bateri për punime skelerie	copë	2	DPOP	30 ditë
7	Aparat fresibël i vogël	copë	5	DPOP	30 ditë
8	Aparat fresibël i madh	copë	5	DPOP	30 ditë
9	Vidiator me bateri me goditje	copë	8	DPOP	30 ditë
10	Aparat ngjitës për tuba plastik	copë	4	DPOP	30 ditë
11	Matës i intensitetit të rrymave me nofull, profesional	copë	7	DPOP	30 ditë
12	Pompë mjegulluese e ftohtë (ULV), elektrike	copë	2	DPOP	30 ditë
13	Sharrë rrethore	copë	3	DPOP	30 ditë
14	Pompë për lyerje muri	copë	1	DPOP	30 ditë
15	Skelë kullë e lëvizshme	copë	1	DPOP	30 ditë

Shpjegim i termave: DPOP → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.2 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur operatori ekonomik ofertues renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët /fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktin objekt të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira, të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier). Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e qarkullimit, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur operatori ekonomik ofertues renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6. Oferta teknike duhet të plotësohet me saktësi nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës. Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Referenca në katalogje	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6.
- Emërtimi i Katalogut ose skedës teknike të prodhuesit/distributorit të autorizuar. Referenca në katalogje, kodi produktit (*në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes*), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ose skedën teknike përkatëse për çdo produkt ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.
- Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa nga mallrat objekt prokurimi, të përcaktuara me nr. Rendor: **3, 4, 5, 6, 9, 12, 14** sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën nr.6.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistem (SPE).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:

Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

<p>legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmartjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>

<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p>Po []</p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
